




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-9835/24 datë: 19.04.2024



Npi – 01/151 datë: 29.04.2024

Bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) neni 17 shkronja (f) dhe (p) dhe nenin 25 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Nenin 5 dhe nenin 11 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/l-087; Nenin 6 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/l-087; Nenin 4 dhe 5 të Rregullores të (QRK) Nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit; Nenin 3 të Rregullores së (QRK) Nr.19/2015 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores të (QRK) Nr.02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e drejtorëve të ndërmarrjeve rajonale të ujit; Si dhe duke marrë për bazë vendimin e Kuvendit Npi-01/45 të datës 31.01.2024, Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më 29.04.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

**PËR DHËNIEN E GARANCIONIT PËR THEMELIMIN E NDËRRMARRJES
PUBLIKE LOKALE**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -IV- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më 29.04.2024, me shumicën e votave miratoi Vendimin për dhënie të Garancionit në shumën prej 10.000 euro si kapital themeltar për formimin e Ndërmarrjes Publike Lokale të Komunës së Shtimes.

II

A r s y e t i m: Me këtë vendim Komuna e Shtimes përkatësisht Kuvendi i Komunës, i pranon të gjitha të drejtat dhe obligimet të cilat rrjedhin nga legjislacioni pozitiv në Republikën e Kosovës të cilat e rregullojnë fushën e formimit të Ndërmarrjes Publike Lokale.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi Kuvendit
Adnan Ademi